

KONTRATË SHITJE

Sot më datë 10/05/2021 palët pjesmarrëse kanë rënë dakort për lidhjen e kontratës së mëposhtme”

PALËT PJESMARRËSE NË KONTRATË :

Erjona Kurtaj , shtetase shqiptare, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me numer personal identifikimi I95603097S , lindur më Shkodër, Shqipëri me adresë banimi Tiranë, Shqipëri. (Shitësi)

Vigan Group, shoqeri tregëtare me përgjegjesi të kufizuar rregjistruar pranë qkb-se e indentifikuar me nipt L61426009D ,me administrator Arsid Rraboshta me nr ID I30419101R me adres kryesore Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Medar Shtylla, Kompleksi Kika 1, Ndertesa nr.43 me nr.pasurie 8/386-N25, 8386-Nr. 26 (Blerësi)

Neni 1

OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është shitja e kuotave zotëruese nga Erjona Kurtaj e cila përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë “**L officina**” me numër unik (NUIS) **M02108502N**, me adresë Tirane Tirane Rruga Muhamet Gjollështa Godina 17, Hyrja 5, Ap 30/2

- Shitjen e kuotës zotëruese nga Erjona Kurtaj e cila përfaqëson **100%** të kapitalit të shoqërisë, **L officina**.

Neni 2

Cmimi

Cmimi i shitjes së 1 (një) kuote e cila përfaqëson 100% të kapitali të shoqërisë “**L officina**” është 100 000 lek .

Neni 3

Afati i pagimit te cmimit

Pagimi i cmimit do të kryhet pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e shitesit

1. Shitësi ka të drejtë të kërkojë nga blerësi pagimin e cmimit ne mënyrën dhe afatin e parashikuar në këtë kontratë.
2. Shitësi është i detyruar t'i dorëzoje blerësit të gjithë dokumentacionit që shënon të drejtën e pronësisë dhe që janë të nevojshme për kalimin e saj.
3. Shitësi duhet te garantoje bleresin per gezimin e qetë te kuotave nga cdo e drejtë pronësie të personave të trete. Shitësi është i detyruar të marrë pjesë në gjykim në mbështetje të blerësit nese ai thirret prej tij, për ta garantuar ndaj pretendimeve te personave te trete, mbi kuotat objekt i kontrates.

Neni 5

Te drejtat dhe detyrat e bleresit

1. Bleresi ka të drejtë te kërkojë dokumentat qe vërtetojnë pronësinë e shitësit mbi kuotat, objekt kontrate nga shitesi nga e nesermja e hyrjes ne fuqi të kësaj kontrate.
2. Bleresi eshte i detyruar të marrë në zotërim vendin ku shoqëria ka qendrën e ushtrimit të aktivitetit

Neni 6

Zgjidhja e kontratës

1. Shitesi ka të drejtë të kërkojë të zgjidhe kontraten kur:

a) blerësi nuk paguan cmimin.

b) blerësi nuk merr në dorëzim objektin ku shoqëria ushtron aktivitetin , brenda 15 ditëve nga afati shtesë i caktuar nga shitësi;

c)blerësi nuk merr në dorëzim dokumentat e pronësisë së kuotave

2.Bleresi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur:

a) shitësi nuk dorëzon dokumentat e pronësisë së kuotave

b)shitësi nuk dorëzon objektin e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë, objekt kontrate brenda afatit shtese 10 ditor, te caktuar nga bleresi ;

b) shitesi deklaron brenda afatit 10 ditor se nuk do te dorezojë dokumentacioni dhe objektin e ushtrimit të aktivitetit;

Neni 7

Pasojat e zgjidhjes se kontrates

1. Shitësi me zgjidhjen e kontratës duhet t'i kthejë pagesat e bëra blerësit, dhe gëzon të drejtën për shpërblimin e dëmit .

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast mosmarrveshje midis tyre palët do t'i zgjidhin me mirëkuptim, dhe vetëm kur një gjë e tillë është e pamundur ato do t'i drejtohen gjykates se “Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Neni 9

Shpenzimet per lidhjen e kontratës

Shpenzimet për lidhjen e kësaj kontrate i ngarkohen te dyja palëve përkatësisht.

Neni 10

Momenti i kalimit të pronësisë dhe Hyrja në fuqi

Kuotat zotëruese të ortakës Erjona Kurtaj në shoqërinë “L officina ”Shpk në datën 10/05/2021 kalojnë në pronësi të **shoqeris Vigan Group Shpk** si më poshtë:

- Kuota zotëruese nga Erjona Kurtaj e cila përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë I kalojnë **shoqeris Vigan Group Shpk.**

Kjo kontratë hyn në fuqi në datën 10.05.2021

Neni 11

Hartimi i kontratës

Kjo kontratë u hartua në **2 (dy)kopje** nga një për secilën palë.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITËSIT :

Erjona Kurtaj



L OFFICINA
M02108502N

BLERESI

Vigan Group Shpk

Arsid Rraboshta



VIGAN GROUP
L314260085
TIRANE, ALBANIA
CEL-0692380085